



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja: Nr. 22

Datë: 04. 04. 2024

Fillimi i takimit: Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Anëtarët e KQZ-së prezentë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Mufera Shinik, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

(Mbledhja në Procedurë Qarkulluese (Online))

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të Sekretariatit për të zhvilluar procedurë emergjente ekstreme për aktivitetin e prokurimit “Marrja me qera e Gjeneratorit”, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut
3. Të ndryshme !

-
1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Për arsye të urgjencës së procesit, ky takim është mbajtur në distancë. Kryetari Radoniqi, ka paraqitur një pikë të rendit të ditës, dhe pika ‘Të ndryshme’!

2. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të Sekretariatit për të zhvilluar procedurë emergjente ekstreme për aktivitetin e prokurimit “Marrja me qera e Gjeneratorit”, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut:

Pika e parë e këtij takimi, ka pasur të bëjë me nevojën e domosdoshme për furnizimin me energji elektrike të selisë së KQZ-së. Sekretariati, i ka rekomanduar KQZ-së për të zhvilluar procedurë emergjente (ekstreme) për aktivitetin e prokurimit: “Marrja me qera e Gjeneratorit”, deri në zgjidhjen e problemit me energji elektrike.

Me 7 vota për, miratohet kjo kërkesë.

Votuan: Kreshnik Radoniqi, Arianit Elshani, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj dhe Qemajl Kurtishi.

3. Të ndryshme !